

www.altax.al

ALTAX

PËRGJEGJSHMËRIA FINANCIARE E PREMTIMEVE TË POLITIKËS SHQIPTARE 2009 - 2017

Një analizë që mat besueshmërinë e premtimeve zgjedhore dhe përmbushjen e këtyre premtimeve si pjesë e programeve qeverisëse

**SA TË BESUESHME KANË
QENË PREMTIMET ELEKTORALE?**

**SA JANË PËRMBUSHUR PREMTIMET ELEKTORALE
NGA PROGRAMET E QEVERIVE PËRGJATË 2009-2021?**

PËRGJEGJSHMËRIA FINANCIARE E PREMTIMEVE TË POLITIKËS SHQIPTARE 2009 – 2017

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Një analizë që mat besueshmërinë e premtimeve zgjedhore dhe përmbushjen e këtyre premtimeve si pjesë e programeve qeverisëse

AL TAX

Tetor 2020 – Shkurt 2021

POLITFAKT.

Deklarimi përgjegjësivë/Disclaimer

Gjetjet, komentet dhe përfundimet e këtij studimi përfaqësojnë vetëm mendimin dhe vlerësimin e autorëve të këtij studimi dhe në asnjë mënyrë nuk përfaqësojnë mendimet apo opinionet e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë.

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij studimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej përdoruesve, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me njohjen e “Qendrës AL-TAX” si burim



Me mbështetjen financiare të
Programit të Granteve të Vogla të
Komisionit për Demokraci të
Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë

Në tërësinë e tij raporti analizon premtimet elektorale përgjate 2009-2017 dhe më tej në pjesët në vijimësi analizohen edhe premtimet elektorale të përfshira në programet qeverisëse, sipas partisë apo koalicioneve që kanë fituar mandatin e votuesve për qeverisje.

Nga zgjedhjet e 2009 (298 premtime), në zgjedhjet e 2013 (270 premtime) dhe deri në zgjedhjet e 2017 (152 premtime) ka një pakësim me 49 përqind të premtimeve të partive. PD ka një pakësim me 3 përqind. PS ka një pakësim të premtimeve me 60 përqind. LSI ka një pakësim me 52 përqind.

Në vitin 2009 opozita (PS dhe LSI) ka një numër premtimesh sa trefishi i premtimeve të pozitës, ndërsa në 2017 pozita ka një numër premtimesh sa gjysma e partive të opozitës (PD dhe LSI).

Nga një krahasim i premtimeve për të tri fushatat zgjedhore lidhur me fokusin nga partitë, shikohet se

Nr.	Premtimet specifike dhe të përgjithshme	2009	2013	2017
1	Premtimet specifike	92%	97%	93%
2	Premtimet e përgjithshme	8%	3%	7%

Shënim. Premtimet analitike të Shtojcës

prezantohen edhe në Tabelë. Ndërkohë, premtimet e përgjithshme dhe ato politike që kanë një natyrë përfaqësimi të përgjithshëm janë shumë më të pakta në peshën e tyre. Këto premtime më së shumti përfaqësojnë tema për anti korrupsionin, për oligarkët, si dhe tema që kanë të bëjnë me të ardhmen e vendit sipas vizionit të partive.

Nw 2009, partitë së bashku kanë bërë premtime më të shumta për bujqësinë dhe fshatin (47 premtime), si dhe për arsimin, rininë dhe gruan (47 premtime). Premtimet për politikën fiskale dhe buxhetin, si dhe premtimet për mbrojtjen sociale dhe pensionet zënë vendin e dytë, dhe në vijim një numër më i pakët i premtimeve janë dhënë për shëndetësinë (26 premtime), si dhe për infrastrukturën dhe veprat publike (23 premtime).

Nw 2013, Partitë kanë bërë premtime më së shumti për infrastrukturën dhe industrinë (40 premtime), për bujqësinë dhe fshatin (33 premtime), për buxhetin dhe politikën fiskale (30 premtime), si dhe për energjinë dhe pasuritë nëntokësore (29 premtime).

Nw 2017, premtimet më të shumta në numër për të tri partitë së bashku i përkasin më shumë politikës fiskale dhe shpenzimeve buxhetore (45 premtime), sektorit të bujqësisë dhe peshkimit (26 premtime), si dhe sektorit të arsimit, gruas dhe rinisë (24 premtime). Sektorët e tjerë kanë një numër të vogël premtimesh.

premtimet specifike dhe të adresuara sipas sektorëve dhe problematikave të zhvillimit të vendit janë në masë dominuese mbi 90 përqind, ashtu si

Rast pwr diskutim

Mosreferimi i premtimeve te politikat afatgjata, një realitet që duhet ndryshuar

Njw diskutim qw pwr bwn njw ndwr elementwt kryesorw tw analizws sonw wshtw mwnyra e qasjes sw partive ndaj dokumenteve kryesore tw vendit, tw tilla si: Strategjitw sektoriale, PEF, KMF dhe PKIE e SKZHI. Secila nga partitë që analizohen ka një nivel jo të lartë të referimit në dokumentet kryesore strategjike sektoriale dhe ekonomike e financiare. PD në zgjedhjet e vitit 2009, kur kërkonte të vijonte qeverisjen ka një referencë të premtimeve te këto dokumente në një nivel të lartë. Megjithatë duke marrë në konsideratë që të gjithë këto dokumente janë hartuar me ekspertë të qeverisë, por edhe të asistuar nga ekspertë të huaj kjo referencë është një qasje e argumentuar. Një nivel jo të lartë referimi ka edhe LSI. Por edhe PS ka një nivel që tregon jo sa nevojitet për vlerësimin e premtimeve bazuar te dokumentet strategjike të vendit, megjithëse është në nivele më poshtë se dy partitë e tjera.

Në zgjedhjet e vitit 2013, PD ulet në një nivel referimi të premtimeve te strategjitë më poshtë se 50% krahasuar me 2009. Kjo tendencë e premtimeve spjegohet me numrin e lartë të tyre për bujqësinë, politikën fiskale dhe turizmin, të cilat nuk janë të parashikuara qartësisht në dokumentet strategjike. Por edhe PS dhe LSI kanë rënie të vogla të referimeve të premtimeve të tyre në dokumentet strategjike, për të njëjtën arsye si në rastin e PD.

Në vitin 2017, të tria partitë kanë rritje të argumentimeve të premtimeve nga referenca te dokumentet strategjike, por përsëri për arsye të euforisë dhe dëshirës për të maksimalizuar votat për partitë e tyre kanë dalë jashtë formateve që përcaktonin strategjitë.

Tab. 5 **Premtimet e referuara te dokumentet strategjike 2009-2017** *numër*

Referenca e premtimit	PD			PS			LSI		
	2009	2013	2017	2009	2013	2017	2009	2013	2017
Te STRATEGJI/PBA	50	40	33	45	63	53	39	42	31
Në raport me premtimet gjithsej	69%	28%	39%	63%	56%	62%	75%	71%	76%

Shënim. Premtimet analitike te Shtojca

Mungesa e referencës në këto dokumente bazë si për partitë që janë në qeverisje, por edhe ato që pretendojnë të qeverisin krijojnë probleme për to të shikojnë efektet e kombinuara të programeve të ndryshme në proces apo të parashikuara. Kjo mangësi ka diktuar natyrshëm qasje të reja më të vështira, pasi nëse shikojmë që çdo qeverisje pothuajse zhbën politikat e kaluara dhe nis politika të reja fillimi. Votuesit nuk arrijnë të kuptojnë se cilat ndryshime rezultojnë efektive të adresohen për vijimësinë e proceseve zhvillimore të vendit.

Një qasje tjetër që ne e kemi shqyrtuar lidhur me mungesën e referencës të partive politike në të njëjtat dokumente strategjike dhe vizionare ka ndikuar dukshëm në mosarritjen e procesit të bashkëpunimit, që ndikon në ndryshime të shpeshta të vizionit të vendit për të njëjtat strategji, ndërsa mundet që të ndryshojnë vetëm përbërësit individualë të programit të vendit, të cilët mund të vlerësohen veçmas pa ndikuar në rezultatin e përgjithshëm.

Programi politik i PS dhe LSI në vitet 2009-2017 ka prezantuar si domosdoshmëri për të ndryshuar modelin e menaxhimit të vendit me qasje dhe mekanizma të rinj. Këto ndryshime janë kërkuar prej votuesve të kuptohen si një axhendë e re radikale për ndryshim. Megjithatë edhe pse premtimet janë bërë duke patur edhe identifikim të partive politike me premtime të caktuara, nëse shikojmë faktet e buxhetit rezultojnë se premtimet janë larg mbajtjes së tyre prej partive.

Premtimet për politikën fiskale

Të dyja krahët e politikës, si të majtët dhe të djathtët kanë premtuar sistematikisht uljen e taksave, apo edhe heqjen e tyre për bujqësinë, peshkimin apo edhe për industrinë minerare. Ndërsa, qasja është e njëjtë dhe ka tentuar në mënyrë të përsëritur të premtojë uljen e taksave, mekanizmat për ta realizuar atë kanë qenë të ndryshëm. Të dy palët në ngjashmërinë e tyre kanë harruar apo nuk kanë trajtuar me përgjegjshmëri fenomenin e evazionit tatimor dhe informalitetit në ekonomi, që ka minuar vazhdimisht qasjen për të bërë ekonomi nëpërmjet uljes së taksave. Sipas të dhënave në Tabelë, pesha e premtimeve për ulje dhe shkurtime normash tatimore në raport me premtimet gjithsej të secilës parti kanë një rritje të dukshme nga PD dhe nga LSI në vitin 2017, respektivisht me 9 përqind dhe 36 përqind. PS ka një numër më të vogël premtimesh në 2017, por në dy fushatat e kaluara ka ruajtur të njëjtën balancë me partitë e tjera në premtimet që ka bërë.

Tab. 6 Premtimet buxhetore dhe fiskale, 2009-2017

Premtimet buxhetore dhe fiskale	PD			PS			LSI		
	2009	2013	2017	2009	2013	2017	2009	2013	2017
Ulje/Heqje Taksash	1%	4%	15%	4%	9%	8%	7%	10%	46%
Shtim shpenzimesh buxhetore	54%	41%	35%	21%	23%	44%	33%	34%	22%
<i>Në raport me premtimet gjithsej</i>	56%	45%	50%	25%	33%	53%	40%	44%	68%

Shënim. Premtimet analitike të Shtojcës

Premtimet për shtimin e buxhetit për sektorët

Kjo kategori premtimesh është pjesa e përbashkët për të gjitha partitë duke mos patur ndryshim në tipin e premtimit, por mënyrën si duan ta arrijnë atë duke përdorur në dekadën e fundit edhe politizimin e mënyrës së taksimit të të ardhurave individuale.


Pesha e premtimeve për shpenzime shtesë nga buxheti në raport me premtimet gjithsej të secilës parti (PD dhe LSI) ka rënie graduale nga zgjedhjet e 2009 te zgjedhjet e 2017. PS ka një kah në rritje të peshës së premtimeve për shtimin e fondeve buxhetore në 2017, por që ndikohet nga ulja e numrit të premtimeve në 2017. Në krahasimin e premtimeve të ngjashme për sektorët e qeverisjes, si dhe për tema sociale shikohet se të gjithë partitë synojnë premtime që dalin përtej mundësive të buxhetit me 2-3 herë më shumë se një vit i zakonshëm fiskal duke marrë parasysh mundësitë e të ardhurave dhe shpenzimeve që mund të prokurohen dhe të realizohen si programe buxhetore. Një spjegim më i hollësishëm jepet në pikën 3.2. më poshtë lidhur me kostot buxhetore të programeve.

Premtimet për punësimin

Në analizën e premtimeve të punësimit, nëse i referohemi studimeve të thelluara rezultojnë një lidhje mes rritjes së PBB-së dhe rritjes së punësimit, e cila vlen në rastin e premtimeve të bëra nga partitë shqiptare. Nisur nga parashikimet dhe fakti mbi treguesit e rritjes ekonomike të prezantuar në serinë e publikimeve të MFE, Kuadri makroekonomik dhe fiskal, 2009-2021 nuk ka patur asnjëherë mundësi reale të rritjes në periudhën 2009-2017 që të përkojë me nivelin e punësimit të premtuar. Nga llogaritjet tona rritja maksimale e mundur me projeksionet e rritjes së PBB-së në Shqipëri nuk premtim për më shumë se 22.000 – 25.000 vende pune për vitet me rritje ekonomike mbi 3.8 përqind dhe me një rritje të pandërprerë dhe jo me luhatje. Ndërkohë, kur shikojmë premtimet për punësimin nga secila parti politike ato kanë rezultuar premtime të pamundura për tu realizuar, as në gjysmën e nivelit të premtuar nga dy partitë e mëdha.

Grafik 1

Premtimet për numrin e të punësuarve, 2009-2017

*Premtimet për mbrojtjen sociale*

Për mbështetjen sociale, premtimet e partive kanë përsëri ngjashmëri në secilën nga tri fushatat zgjedhore që kemi analizuar. Në të gjitha premtimet e partive ka një ofertë për kryerje shpenzimesh shtesë, në rast të fitimit të zgjedhjeve, që shkojnë nga 2 deri 3 herë më shumë nga sa përfituesit kanë marrë në kohën kur është kryer premtimi (shih Tabelën 7). Ndërsa shikojmë se premtimet janë rritur me disa herë, kur analizojmë rritjen reale të ndihmës ekonomike ajo nuk është më shumë se 50% e vlerës së premtuar nga secila parti, duke përfshirë në këtë llogaritje premtimet që nga viti 2009.

Tab.7 Shpenzimet për mbështetje sociale, 2009 -2020

mld. Lekë


Nr.	Shpenzime për mbështetje sociale	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
1	Pagesa e Papunësisë	868	982	876	984	800	912	615	691	346	336	505	888
2	Ndihma ekonomike	16,061	16,706	16,369	18,011	19,370	22,849	17,662	20,026	20,714	20,671	20,189	23,996
3	Kompensimi ish-përndjekurve	2,200	1,000	1,500	1,699	2,991	1,759	1,967	1,979	2,298	997	1,199	1,000
4	Bonusi lindjeve/Kompensim pasurie			1,600								2,364	2,820
GJITHSEJ		19,129	18,688	20,345	20,694	23,161	25,520	20,244	22,696	23,358	22,004	24,257	28,704

Burimi: MFE

Premtimet për pensionet

Premtimet për rritjen e pensioneve janë një tjetër ngjashmëri në qasje të fushatave të partive politike. Të gjitha partitë kanë bërë premtime të natyrave të ndryshme, por që gjithnjë kanë demonstruar vullnetin për rritjen e pensioneve. Nëse analizojmë faktin e rritjes së pensioneve nga viti bazë i analizës 2009 dhe deri më sot, ashtu si tregohet te Grafik 2, premtimet për një rritje pensionesh dy -tri herë në raport me vitin bazë, kur ballafaqohen me rritjen faktike të tyre deri në vitin 2020 nuk tregojnë më shumë se 36 përqind rritje.

Grafik 2



Duke mos pretenduar që të kemi shteruar gjithë listën e argumentave të ngjashme, ne shikojmë se premtimet e dhëna nuk janë mbajtur për këto segmente përfituesish, që lidhen me kategori mjaft të ndjeshme votuesish. Realizimi i premtimeve me tendencën e performancës së përmbushjes për periudhën 10 vjeçare mund të arrihet për të paktën prej 15-17 vitesh.

Nisur nga llogaritjet, mendojmë se ka pak vend për premtime shtesë, duke qenë se llogaritjet fiskale nuk shikojnë hapësirë për shpenzime të shtuara të buxhetit, nisur nga koha që jetojmë dhe ndikimet që ka buxheti nga katastrofa natyrore e vitit 2019, si dhe kriza globale shëndetësore e vitit 2020 dhe që vijon edhe në vitin 2021.

Premtimet dhe konsistenca e tyre gjatë fushatave elektorale

Në analizën e këmbënguljes ndaj premtimeve sipas sektorëve të partive politike, sipas Tabelës 9 kemi vërejtur një këmbëngulje më të fortë për premtime për grupet e votuesve, që lidhen me qasjet ideologjike të partive, por që kanë devijime përgjatë fushatave.

Për pjesën sociale edhe pse ka një numër më të lartë premtimesh nga PS, shikohet se ato kanë ardhur në rënie përgjatë harkut kohor të zgjedhjeve 2009-2017. E njëjta situatë e premtimeve shikohet edhe për sektorin shëndetësor, si dhe për bujqësinë e turizmin. Ndërsa, premtimet për infrastrukturën kanë luhate të madhe, që lidhet më së shumti me politika që përkojnë me qasjet dhe strategjinë për të qenë pranë votuesve me sa më shumë premtime elektorale në momente, kur ato sipas sondazheve partiake vlejnë më shumë.

Një luhate e tillë dhe mungesë konsistence në premtime vërehet edhe për PD, që përveç premtimeve fiskale dhe buxhetore që vijnë në rritje, për pjesën tjetër të premtimeve nuk shikohet të ruhet qëndrueshmëria.


PD ka një përsëritje konstante të premtimeve buxhetore dhe fiskale dhe me një tendencë në rritje të përqindjes së përsëritjes (nga 8% në 2009 në 17% në 2017). PS ka një përsëritje të premtimeve nga niveli 4% në 2009 në 10% në 2017. LSI ka një cikël të ngjashëm të premtimeve të përsëritura buxhetore dhe fiskale, ku në 2009 ka përsëritur vetëm 4% të premtimeve, ndërsa në 2017 ka përsëritur 15% të premtimeve të mëparshme.

Në rastet e përsëritjeve të premtimeve ato shkojnë në funksion të shtimit të buxheteve për sektorët e bujqësisë, arsimit, si dhe të shëndetësisë.

Në asnjë rast partitë politike nuk kanë bërë premtime për shkurtrim shpenzimesh buxhetore apo shtim të taksave.

Grafik 3

Premtimet e partive për taksat dhe buxhetin (numër)



Premtimet me natyrë buxhetore dhe kostot e tyre

Premtimet zgjedhore kanë patur tipar të tyre me rëndësi për strategjitë elektorale të partive politike koston buxhetore për secilin vit që janë zhvilluar zgjedhjet që ne kemi analizuar (2009, 2013 dhe 2017).

Nëse e shikojmë këtë rëndësi nga ana e sasisë së premtimeve shikojmë se premtimet për shtim shpenzimesh buxhetore kanë një ulje për secilën nga partitë kryesore. Ndërsa, premtimet për politikën fiskale (ulje/heqje taksash) kanë një rritje të tyre nga njera-fushatë në tjetrën.

Në llogaritjen që kemi bërë për kostot buxhetore të premtimeve sipas sektorëve ku ato janë adresuar janë marrë në konsideratë llogaritjet bazuar mbi efektet pozitive, për rastet e ndikimeve të tilla në ekonomi dhe sistemin fiskal, si dhe efektet negative që nuk përfshijnë brenda tyre pjesën e buxhetit që është i zbatueshëm përpara premtimit (efekte neto financiare dhe fiskale të premtimeve). Kjo llogaritje është bërë mbi bazë premtimesh, për të sqaruar lexuesin se sa mundet të shkojë një llogaritje e caktuar nëse hipotetikisht, gjithë premtimet që janë dhënë do të ishin të mundshme për tu realizuar.

Tab.8 **KOSTOT FISKALE E BUXHETORE TE PREMTIMEVE ELEKTORALE, 2009, 2013 DHE 2017** *mld. Lekë*

Nr.	Efekti te Buxheti i Shtetit	PD			PS			LSI		
		2009	2013	2017	2009	2013	2017	2009	2013	2017
1	Të hyra në buxhet	10	11	11	9	19	22.5	9	11	8.5
2	Shpenzime në buxhet	-123.4	-126	-147	-47.5	-131.5	-98	-66.2	-141.1	-138
REZULTATI/EFEKTI NË BUXHI		-113.4	-115	-136	-38.5	-112.5	-75.5	-57.2	-130.1	-129.5

Shënim. Tabelat analitike të kostove janë të Shtojca

- PD ka një nivel premtimesh në vlerë, lidhur me shtimin e shpenzimeve buxhetore më shumë se partitë e tjera në vitet 2009 dhe 2017, por po ashtu edhe në efektin e të ardhurave fiskale në vitin 2009 dhe 2013. Rritja e të ardhurave më të mëdha në 2013 vjen nga efekti i premtimit të rritjes së pagës dhe të punësuarve. Peshën më të madhe të efekteve të shtimit të shpenzimeve në 2009 e mbajnë premtimet për infrastrukturën, për bujqësinë dhe për arsimin. Në vitin 2013, këtë peshë e mbajnë premtimet për pensionet, për bujqësinë dhe infrastrukturën. Në vitin 2017, peshën më të madhe të shtimit të shpenzimeve për buxhetin e mbajnë premtimet e dhëna për heqjen/uljen e taksave, arsimit, ulja e kontributit të sigurimeve dhe pensionet.

- PS ka një shtim në vlerë të dallueshme në të ardhurat fiskale në vitin 2013 dhe 2017 dhe kjo vjen si pasojë e premtimit për punësim në sasi shumë të mëdha, si dhe efektet e investimeve në vitin 2017 me paketën 1 miliard. Peshën më të madhe të efekteve të shtimit të shpenzimeve e mbajnë premtimet për infrastrukturën, për bujqësinë dhe për arsimin. Peshën më të madhe të efekteve të shtimit të shpenzimeve në 2009 e mbajnë premtimet për infrastrukturën, për shëndetësinë dhe për arsimin. Në vitin 2013, peshën më të madhe e mbajnë premtimet për infrastrukturën rrugore dhe ndërtimore turistike, për bujqësinë, për energjinë, ujësjellës-kanalizime dhe shëndetësinë. Në vitin 2017 peshën më të madhe të shtimit të shpenzimeve për buxhetin e mbajnë premtimet e dhëna për bujqësinë, infrastrukturën rrugore, arsimin.

- LSI ka një efekt të shtimit të shpenzimeve në buxhet duke filluar nga viti 2013 dhe në vijim në vitin 2017. Shtimi i shpenzimeve buxhetore nga premtimet në vitin 2013, rëndohet nga premtimet për infrastrukturën rrugore, për arsimin, për shëndetësinë dhe për bujqësinë. Në vitin 2017, shtimi i shpenzimeve buxhetore vjen nga premtimet për shëndetësinë, arsimin, bujqësinë dhe mbrojtjen sociale. Në premtimet e vitit 2009 llogaritet si një hyrje shtesë në të ardhurat nga premtimet për investimet e huaja dhe zhvillimin ekonomik. Efekte pozitive në buxhet nga punësimi janë të një niveli më të vogël se dy partitë e mëdha.

Rast

A e kanë ndjekur ideologjinë e tyre politike partitë me premtimet e dhëna?

Politikanët e djathtë, bazuar në mendimin e përgjithshëm mbi orientimet politike duhet të mos shohin grupe dhe klasa shoqërore, pasi politika e djathtë zakonisht suksesin e bazon te përpjekjet individuale, duke anashkaluar mbështetjen sociale.

Nga ana tjetër, politikanët e majtë që kanë qasje të përgjithshme barazinë dhe një qeverisje aktive priren të përqendrohen në kategori sociale dhe nevojat e grupeve të ndryshme në nevojë.

Në dhënien e premtimeve të partive të majta (PS dhe LSI) shikohet dukshëm se brenda qasjeve të politikës sociale dhe sektorëve të shëndetësisë, bujqësisë dhe edukimit ka një prirje të lidhur me orientimin e premtimeve për qeverisjen e vendit drejt barazisë sociale, por me qasje të motivuar nga liritë individuale, të cilat shihen të mënyra se si kërkohet që të shpërndahet barra fiskale nëpërmjet parimit të progresivitetit.

Ndërsa partia kryesore e krahut të djathtë (PD), e cila ka qeverisur vendin nga viti 2005 deri në 2013 ka premtuar në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013 nisur nga një filozofi që për nga trajtimi fiskal është qasje konservatore duke premtuar vijimësinë e taksimit të sheshtë (me një shkallë tatimore). Nga ana tjetër, nisur nga nevoja elektorale të momentit, prirja e politikës është orientuar në një pjesë të konsiderueshme me premtime (58% e premtimeve) të adresuara drejt shpenzimeve infrastrukturore, bujqësisë dhe arsimit.

Arsye e qenësishme është realiteti social, ku votuesit i kushtojnë vëmendje politikës, por jo ekonomisë. Nëse politikanët premtojnë preferenca politikash një dimensionale, qytetarët kanë më shumë të ngjarë të mendojnë në po atë lloj qasje, pavarësisht krahut politik. Natyra e konkurrencës partiake formon shkallën në të cilën pikëpamjet e votuesve përshtaten me dimensionin majtas-djathtas. Kështu, nga premtimet e analizuara shikohet se për premtimet për bashkëpunimin me Kosovën, për integrimin në BE, ku partitë politike kanë qasje të njëjta nuk ka rëndësi për votuesin dimensionin i krahut politik. Nëse liderët politikë dhe partitë që ata drejtojnë nuk kanë konflikte mes njeri-tjetrit, votuesit me gjasa nuk do të perceptojnë ato premtime politike në të majta apo të djathta.

Vlerësimi i premtimeve dhe matja e tyre

Nga vlerësimi i premtimeve zgjedhore, *gjetja kryesore e zgjedhjeve të vitit 2009* është se partitë që janë pjesë e koalicionit qeverisës 2005-2009 (PD dhe aleatët e djathtë) kanë nivel besueshmërie me një shumicë të qartë të premtimeve të besueshme dhe atyre që janë të besueshme pjesërisht në nivelin 72 përqind.

LSI, e cila garoi e vetme në zgjedhjet e vitit 2009 ka një besueshmëri të premtimeve të besueshme dhe pjesërisht të besueshme 72 përqind.

PS, e cila gjithashtu garoi në koalicion me parti të tjera të majta ka një nivel besueshmërie të premtimeve të besueshme dhe pjesërisht të besueshme të 75 përqind.

Sipas *Tabelës 11*, në tërësinë e gjithë premtimeve elektorale të vitit 2009, nga vlerësimet e kryera, niveli i besueshmërisë për premtimet e besueshme dhe pjesërisht të besueshme arrin në 73 përqind, ku:

- 18 përqind e tyre janë të besueshme (55 premtime);
- 55 përqind e tyre janë pjesërisht të besueshme (164 premtime);
- 27 përqind e tyre janë të pamatshme (79 premtime).

Gjetja kryesore e zgjedhjeve të vitit 2013 është se partitë që ishin pjesë e koalicionit qeverisës 2009-2013 (PD dhe LSI), ku edhe pse LSI në këto zgjedhje garon si koalicion parazgjedhor me PS kanë një nivel të premtimeve të besueshme dhe atyre që janë të besueshme pjesërisht të 72 përqind për PD dhe 70 përqind për LSI.

PS garoi në këto zgjedhje si një parti opozitare, por me një marrëveshje parazgjedhore me LSI duke siguruar një nivel besueshmërie të plotë dhe të pjesshme prej 79 përqind nga premtimet e saj.

Në kontekstin e analizës sonë, nga vlerësimet e kryera, niveli i besueshmërisë për premtimet e besueshme dhe pjesërisht të besueshme arrin në 74 përqind (1 përqind më i lartë se në zgjedhjet e vitit 2009), ku:

- të besueshme janë 18 përqind e tyre (49 premtime);
- pjesërisht të besueshme janë 56 përqind e tyre (151 premtime);
- të pamatshme janë 26 përqind e tyre (70 premtime).

Gjetja kryesore e zgjedhjeve të vitit 2017 është se partitë e koalicionit qeverisës 2013-2017 kanë dalë në këto zgjedhje të ndara nga njera-tjetra. Në këto zgjedhje nuk ka asnjë marrëveshje parazgjedhore mes partive kryesore në vend edhe pse marrëveshja politike para zgjedhjeve mes PS dhe PD pati shumë kundërshtime nga baza e partive të mëdha.

PD në këto zgjedhje në raport me totalin e premtimeve të besueshme dhe ato të besueshme pjesërisht arrin në nivelin 81 përqind.

PS në këto zgjedhje në raport me totalin e premtimeve të besueshme dhe ato të besueshme pjesërisht arrin në nivelin 97 përqind.

LSI në këto zgjedhje në raport me totalin e premtimeve të besueshme dhe ato të besueshme pjesërisht arrin në nivelin 91 përqind.

Nga vlerësimi i premtimeve sipas nivelit të matjes së tyre, rezultojnë se premtimet e besueshme dhe pjesërisht të besueshme arrijnë të 90 përqind (16 përqind më lartë se në zgjedhjet e vitit 2013), ku:

- të besueshme janë 38 përqind e tyre (57 premtime);
- pjesërisht të besueshme janë 52 përqind e tyre (79 premtime);
- të pamatshme janë 10 përqind e tyre (16 premtime).

Vlen të theksohet se premtimet e pamatshme kanë një ulje të dukshme me 16 përqind krahasuar me zgjedhjet e kaluara, që në fakt një ndikim në këtë trigues ka numri i vogël i premtimeve.

PD ka më shumë premtime të besueshme për infrastrukturën dhe veprat publike, si dhe ndërkohë më pak të besueshme për bujqësinë, për infrastrukturën dhe për arsimin, gruan dhe rininë.

PS ka premtime të besueshme më shumë në sektorë të tillë si: buxheti dhe politika fiskale, bujqësia dhe fshati, të natyrës së reformimit dhe të përgjithshme, si dhe shëndetësinë.

LSI ka premtime të besueshme më shumë në sektorin e arsimit, gruas dhe rinisë, si dhe në bujqësi, shëndetësi dhe mbrojtjen sociale.

2017

PD ka më shumë premtime të besueshme për bujqësinë, turizmin dhe arsimin dhe ndërkohë më pak të besueshme për politikën fiskale dhe buxhetore.

PS ka premtime të besueshme më shumë në sektorë të tillë si: buxheti dhe politika fiskale, bujqësia dhe arsimi, ndërsa më pak të besueshme ka përsëri për arsimin dhe politikën fiskale.

LSI ka premtime të besueshme më shumë në sektorin e bujqësisë, ndërsa më pak të besueshme po në bujqësi, si dhe në politikën fiskale.

Rast

Efekti i premtimeve të LSI në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013, si pjesë e qeverisjeve

Si një rast i veçantë për tu trajtuar është LSI me premtimet e saj në fushatën e vitit 2009, kur pas tyre hyri në koalicionin qeverisës me PD, si dhe në fushatën e vitit 2013, kur kishte bërë marrëveshje parazgjedhore për të qeverisur në një koalicion me PS dhe parti të tjera të majta.

Në zgjedhjet e vitit 2009, LSI vjen me premtime të shumta për arsimin, bujqësinë dhe politikën sociale duke përfshirë këtu edhe politika specifike për mbështetjen e industrisë fason dhe ato për pensionet e ushtarakëve të liruar nga detyra dhe për minatorët. Në njëfarë niveli përfshirje këto premtime janë të përbashkëta me disa nga premtimet kryesore të PD, por edhe PS për të njëjtat sektorë.

Në zgjedhjet e vitit 2013, premtimet kryesore të LSI janë adresuar në sektorin e infrastrukturës, bujqësisë, si dhe politikave fiskale. Në këto zgjedhje ajo premtonte në disa sektorë ku PS si forcë politike kryesore ka bërë premtime më të pakta. Një ndër arsyet kryesore të kësaj divergjence premtimesh për disa sektorë si arsimi dhe politikën sociale LSI ka një ulje të intensitetit të premtimeve.

Në analizën që bëhet për premtimet elektorale sipas sektorëve, përveçse shihet se sa faktor ndikues është secila parti në koalicionin e ardhshëm qeverisës, një faktor ndikues është edhe fakti i qeverisjeve të kaluara që partitë dominuese në qeveri nuk kanë dhënë në asnjë rast financat në drejtim të partisë që është minorancë në koalicion.

Nëse shikojmë ndikimin e LSI si efekt në devijimin e mbajtjes së premtimeve nga të dyja krahët e qeverisjeve, shikohet se është në shkallë të ndryshme të përmbushes përgjatë mandateve që janë votuar.

Në rastin e qeverisjes së demokratëve me LSI ka patur një nivel mbajtje premtimesh prej 22 %.

Në rastin e qeverisjes së socialistëve me LSI ka patur një nivel mbajtje premtimesh prej 37 %.

Ndërsa kur socialistët kanë qeverisur të vetëm për një periudhë 4 vjeçare rezulton një nivel mbajtje premtimesh prej 50%.

Nga sa shikojmë vërehet se efekti më i madh në deijimin e mbajtjes së premtimeve shihet në rastin e qeverisjes midis PD dhe LSI, ku një pjesë e premtimeve janë edhe si rrjedhojë e një qasje ndryshe të të majtës nga e djathta, por edhe për arsye të mungesës së një marrëveshje parazgjedhore midis tyre.

Ndërkohë, një rritje e efektit të LSI në qeverisje shikohet në 2013, megjithëse nuk mund të konsiderohet një përmbushje në nivel të lartë.

Rast

Premtimet për punësimin dhe fakti i mbajtjes së tyre nga qeveritë

Premtimet për krijimin e vendeve të punës janë shumë të popullarizuara për fushatat elektorale në këto dekada të fundit. Veçanërisht ato kanë qenë më agresive kur ambienti ekonomik ka qenë i dobët dhe niveli i papunësisë ka përbërë një problem.

Në parim, një premtim për krijimin e vendeve të reja të punës mund të jetë i arsyeshëm, por edhe i paarsyeshëm. Për të qenë i arsyeshëm, premtimi duhet të përfshijë mënyrën se si kandidati për kryetar qeverie propozon për të arritur rezultatin dhe si do të jetë efekti në buxhetin e shtetit nga ky veprim, i cili lidhet me mundësinë e investimeve, por edhe me mundësinë për rritjen e bazës së kontribuesve për tatime dhe kontribute sigurimesh. Punët mund të krijohen nga ndërhyrja dhe shpenzimet direkte të qeverisë, një strategji që duhet prezantuar në programet elektorale si një kapitull shumë i rëndësishëm dhe i vecantë. Këto projekte mundet të krijojnë vende pune për një numër të madh qytetarësh të papunë. Por nga ana tjetër, në kushtet kur investimet e huaja që janë të lidhura direkt me punësimin nuk prezantohen në mënyrë të qartë dhe transparente me projekte konkrete do të përbënin një shembull negativ dhe objekt polemikash politike. Në këtë dekadë të fundit, projektet e investimeve private nuk kanë arritur të përmbushin dot nivelet e larta të punësimit, të premtuara me bujë në premtimet elektorale dhe nuk kanë arritur të sigurojnë shpresë të mjaftueshme për ekonominë shqiptare që vihet në vijimësi në vështirësi.

Tab. 16 **Premtimet për numrin e të punësuarve dhe fakti i tyre, 2009-2017**

numër

Nr.	Premtimet për punësimin	2009	Punësime Qeverisja 2009-2013	2013	Punësime Qeverisja 2013-2017	2017	Punësime Qeverisja 2017-2021*
1	PD	160,000	49,000	260,000	198,000	0	89,000
2	PS	197,000		300,000		220,000	
3	LSI	100,000		225,000		170,000	

Shënim. Premtimet analitike të Shtojcës

* Llogaritjet nuk janë përfundimtare

Në krahasimin që mund të bëhet midis premtimeve të partive për punësimin dhe nivelit të punësimit faktik për 4 vite, në të tri qeverisjet e paraqitura në Tabelën shihet se nuk është arritur as niveli 50% i premtimit të bërë.

Kjo performancë natyrisht, që përveç se lidhet edhe me triguesit e tjerë të parealizuar si performanca e ekonomisë që nuk ka arritur triguesit e rritjes së premtuar, por edhe investimet e huaja dhe të brendshme nuk kanë qenë të mundur të krijojnë vende pune më shumë se ky nivel duhet tu shërbejnë partive për të bërë premtime që mësojnë nga euforia politike e të kaluarës e bërë nga vetë këta politikanë që janë edhe sot duke premtuar.

Premtimet për investime të mëdha dhe monitorimi i pakët i tyre nga publiku

Në fushatën e vitit 2009, vlera e premtimeve për infrastrukturën nga drejtuesi i PD-së llogaritet në 25 miliardë lekë/vit, ndërsa drejtuesi i PS bëri premtime për të njëjtin sektor në një vlerë të llogaritur 10 miliard lekë/vit.

Në fushatën e vitit 2013, vlera e premtimeve për infrastrukturën nga drejtuesi i PD-së llogaritet në 35 miliardë lekë/vit, ndërsa drejtuesi i PS bëri premtime për të njëjtin sektor në një vlerë të llogaritur 36 miliard lekë/vit.

Në fushatën e vitit 2017, vlera e premtimeve për infrastrukturën nga drejtuesi i PD-së llogaritet në 1.5 miliardë lekë/vit, ndërsa drejtuesi i PS bëri premtime për paketën 1 miliard, por që për secilin nga vitet e qeverisjes ajo llogaritet të jetë 16 miliard lekë/vit.

Këto fonde që në rastin e qeverisjes së PD kulmojnë me rrugën e kombit, e cila ka arritur për periudhën nga fillimi i saj deri më sot mbi 130 miliard lekë, në rastin e PS kulmojnë me paketën 1 miliard US.Dollarë që përkrijnë si kundëvlerë me kulmimin e PD-së. Ndryshimi është që këto premtime përsëriten një herë në 10 vite dhe që kanë tendencën, që sa herë që buxheti arrin të mbizotërojë situatën e borxhit publik duke ulur nivelin e tij, vijnë premtime në këto dimensione që e shndërrojnë gjithë politikën dhe mundimet e ekonomisë anemike, të mos arrijë dot asnjëherë të kapërcejë nivelet e rritjes ekonomike që premtohen nga të dy partitë e mëdha

Një buxhet i madh nuk garanton një vlerë ekonomike më të mirë për publikun.

Politikanët shqiptarë, ashtu si edhe në vende të tjera e kanë premtim kryesor, por edhe program parësor ndërtimin e një infrastrukture të re. Kjo bëhet edhe më e dukshme në rastin e vendit tonë që ka mungesa të mëdha në këtë drejtim. Por, politikanët i favorizojnë projektet e mëdha në krahasim me ato më të vogla, përveç pjesës së marketingut të punës së qeverisë edhe sepse është më lehtë të kapërcejmë kundërshtimin dhe pengesat burokratike dhe mundësia që ti shohim ato deri në realizim brenda mandatit 4 vjeçar është shumë e madhe. Megjithatë, investimet në projektet e mëdha të infrastrukturës duhet të bëhen me qëllime të qarta në mendje dhe këtu në projektet e kaluar duket se nuk është analizuar dhe vlerësuar përfitimi ekonomik i këtyre investimeve. Një provë e qartë është dhënia me koncesion e mirëmbajtjes së rrugës së Kombit, e cila është një investim që përveç tejkaloi mundësitë e financimit nga buxheti jonë, në po të njëjtën vështirësi e ka vendosur gjithë këto vite edhe për mirëmbajtjen e saj. Por, kostoja për gjithë këtë investim shumë të madh për buxhetin mund të rimerret pas më shumë se 100 vitesh dhe natyrisht që ky nuk është një investim i bazuar te përfitimi ekonomik.

Nëse një investim nuk adreson një nevojë të qartë publike, ai mund të rezultojë në një rast dështimi të menaxhimit fiskal dhe ekonomik.

Programi qeverisës dhe niveli i realizimit të premtimeve, 2009-2021

Rast referues

Sa është niveli i përmbushjes së premtimeve nga qeveritë europiane të dekadave të fundit?

Qeveritë Prodi I dhe Berlusconi II përmbushën 41% dhe 58% përkatësisht të premtimeve të tyre elektorale. Këto rezultate janë te optimalet e pritshmërive mbi premtimet lidhur me përmbushjen e tyre nga qeveritë. Nuk është për t'u habitur, rezultati i përmbushjes së qeverisë Prodi I, e cila nuk e përfundoi mandatin e saj dhe ishte një qeveri pakice, krahasuar me qeverinë Berlusconi II, e cila kishte një shumicë të zgjeruar parlamentare dhe zgjati katër vite. Sidoqoftë, Prodi arriti të përmbushë 41% të 218 premtimeve në më pak se dy vite. Rezultati i përmbushjes së Berlusconiit është shumë i ngjashëm me rezultatin mesatar për partitë me një shumicë të thjeshtë parlamentare (mesatarisht 59% në Hollandë, 54.5% në Irlandë)

Kur shikojmë *nivelin e përmbushjes* nga qeveria të premtimeve të dhëna në fushatë zgjedhore rezulton një nivel jo më shumë se 20 përqind duke përfshirë në këtë vlerësim edhe premtimet në progress përmbushje. Niveli i premtimeve të papërmbushura është i lartë me 41 përqind të peshës që mbajnë nga gjithë premtimet e manifestit politik.

Sektorët dhe premtimet që kanë një përmbushje më të madhe janë shëndetësia, turizmi, punësimi. Mospërmbushjen më të madhe e gjejmë në sektorët e arsimit, punësimi, turizmi, politikat buxhetore.

Vlera e premtimeve dhe treguesit e alokuar buxhetorë për këto premtime, 2009-2013

Premtimet për *mbrojtjen dhe përkujdesjen sociale* megjithëse kanë zënë vend të madh në programet e qeverisë ato nuk i kanë kushtuar buxhetit 4 vjeçar më shumë se 70 përqind e kostos së premtuar.

Premtimet për *bujqësinë*, si një sektor që merr vëmendje të shtuar në fushatë zgjedhore edhe pse është premtuar të shpenzohen deri 35 miliardë lekë shtesë, në fakt nuk ka arritur të alokohen burime shtesë më shumë se 10% e shumës së premtuar.

Premtimi tjetër shumë specifik lidhur me *nivelin e pensioneve në fshatra* është i papërmbushur, pasi është realizuar në 4 vite deri në niveklin 80 përqind të premtimit që dhanë partitë e koalicionit. Mospërmbushje kanë edhe premtimet për rritjen e *pensionit në përgjithësi*. Ndërsa u premtua të shtohet buxheti në funksion të rritjes deri në

nivelin e 14.7 miliard lekëve, fakt mbeti se buxheti për 4 vite nuk alokoi dot më shumë se 7.4 miliardë lekë shtesë.

Premtimet për arsimin kanë një vend mjaft të madh në premtimet e partive, por nëse krahasojmë vlerën e premtuar të buxhetit (30 miliard lekë) me alokimet shtesë faktike që janë bërë në 4 vite, rezulton se vetëm 29 përqind e premtimeve janë mbuluar nga buxheti me fondet e investuara nga qeveria.

Premtimet për infrastrukturën rrugore zënë një hapësirë në fondet e premtuara të buxhetit për më shumë se 47 përqind të gjithë fondit 4 vjeçar (294.1 miliard lekë) për investime publike. Vendin kryesor në gjithë këtë vlerë të premtuar e mban rruga e Kombit, që në kohëzgjatjen e saj të paktën 10 vjeçare ka konsumuar 130 miliard lekë. Nisur nga fakti se shpenzimet kapitale të buxhetit tonë nuk shkojnë më shumë se 70 miliard lekë në vitin më kulmor, ky premtim ka qenë më i madhi në historinë e zgjedhjeve që po analizojmë. Nëse shikojmë nivelin faktik të fondeve shtesë të alokuara nisur nga premtimet e dhëna, shikohet se përmbushja me fonde është tejkaluar me 40 miliard lekë. Kjo faturë buxhetore në këto nivele ndikoi në mënyrë direkte në shtimin e borxhit publik me 5.16 përqind.

Premtimet për ujësjellësa dhe rrjetin e kanalizimeve llogaritet të zënë një vlerë jo të vogël në premtimet zgjedhore të partive të koalicionit (20 miliard lekë). Në fakt nga krahasimi me alokimet e buxhetit për këtë sektor shikohet se nuk është përmbushur më shumë se 7.5 përqind e vlerës së premtuar.

Në aspektin e optimizimit të ekonomisë, premtimi më i përgjithshëm por me mjaft peshë për rritjen e *investimeve të huaja në ekonominë* e vendit duket se nuk ka arritur të jetë më shumë se 2.8 miliard Euro në 4 vitet e qeverisjes së PD dhe LSI. Por, llogaritjet tona tregojnë se ka patur një kontribut prej 4 miliard lekë nëpërmjet arkëtimit të taksave të konsumit, si dhe tatimit mbi të ardhurat, përfshirë edhe taksat kombëtare dhe ato vendore.

Politika fiskale e premtuar ka dhënë një efekt shtesë në të ardhurat e buxhetit me 20 miliard lekë. Ky kontribut vjen më së shumti nga efektet e taksave nacionale (15 miliard lekë), kontributet e sigurimeve (10.2 miliard lekë), si dhe tatimit mbi të ardhurat personale (2.8 mld. Lekë). Por nga ana tjetër, edhe pse janë bërë përjashtime për TVSH ato nuk kanë dhënë efektet e pritshme pasi efekti është vetëm 1.9 miliard lekë, por që më së shumti është ndikim nga rritja e konsumit nga investimet. Po kështu edhe tatim fitimi ka një ndikim negativ me minus 2 miliard lekë. Natyrisht, nëse mund të përfshijmë në analizën e fakteve të buxhetit edhe diskutimin lidhur me ndikimin e taksës së sheshtë vlen të thuhet se ndikimi i saj është i pakët ndër gjithë nevojat që ka patur buxheti për të ardhura. Në tërësi, taksa e sheshtë ka dhënë një efekt rezultatant (\pm) me jo më shumë se 800 milionë lekë. Kjo qeverisje nuk arriti dot të përmbushte premtimet lidhur me luftën ndaj informalitetit dhe kjo politikë bashkë me antikorrupsionin mbeti sfidë që nuk u adresua dot sipas premtimeve të dhëna edhe pse treguesit janë më të ulët se pasardhësit¹.

Programi qeverisës dhe niveli i realizimit të premtimeve, 2013-2017

Nëse shikojmë *nivelin e përmbushjes* nga qeveria të premtimeve të dhëna në fushatë zgjedhore rezulton një nivel jo më shumë se 36 përqind me një rritje të nivelit krahasuar me qeverisjen paraardhëse me 16 përqind. Niveli i premtimeve të papërmbushura është i lartë me 27 përqind të peshës nga gjithë premtimet e manifestit politik, por edhe ky nivel është dukshëm më ulët se qeveria e mëparshme me 14 përqind ulje të nivelit të tij.

Premtimet për *mbrojtjen dhe përkujdesjen sociale* kanë zënë vend të madh në programet e qeverisë dhe janë ndër premtimet që i kanë kushtuar buxhetit 4 vjeçar 51% përqind të koston së premtuar.

¹ <https://tradingeconomics.com/albania/corruption-index>

Premtimet për *bujqësinë*, si një sektor që mori shumë premtime dhe vëmendje në fushatën zgjedhore edhe pse është premtuar të shpenzohen më shumë se 34 miliardë lekë shtesë ka përfituar burime shtesë sa 25% e shumës së premtuar.

Mospërmbushje nga buxheti ka edhe premtimi për rritjen e *pensionit në përgjithësi*. Ndërsa sipas premtimit llogaritjet tregojnë se buxheti duhej të shtohet në funksion të rritjes deri në nivelin e 13.5 miliard lekëve, në fakt buxheti për 4 vite nuk alokoi dot më shumë se 70 përqind fonde shtesë.

Premtimet për arsimin renditen ndër sektorët që kanë një vend mjaft të madh në premtimet e partive të majta. Në fakt, kur krahasojmë vlerën e premtuar të buxhetit të llogaritur në 14.5 miliard lekë, rezulton se alokimet shtesë faktike që janë bërë në 4 vite mbulojnë 11 përqind të vlerës së premtimeve që ka alokuar buxheti.

Premtimet për infrastrukturën rrugore llogariten për një vlerë prej 75 miliard lekë, por që shumica e kësaj vlere shkon për mbulimin e kostove të prapambetura edhe pse vlera e saktë nga koalicioni partive të majta nuk njihet e plotë. Vendin kryesor në gjithë këtë vlerë të premtuar e mban shpenzimet për të përfunduar investimet e filluara nga qeverisja e mëparshme. Nëse shikojmë nivelin faktik të fondeve shtesë të alokuara, shikohet se përmbushja me fonde është jo më shumë se 39% e vlerës së premtuar për tu shpenzuar për infrastrukturën rrugore.

Kur analizojmë premtimet për ujësjellësa dhe rrjetin e kanalizimeve llogaritjet zënë një vlerë jo të vogël në premtimet zgjedhore të partive të koalicionit (15 miliard lekë). Por, nga krahasimi me fondet e alokimeve të buxhetit për këtë sektor shikohet se është përmbushur dhe tejkaluar vlera e premtuar me më shumë se 15 përqind.

Në aspektin e optimizimit të ekonomisë, premtimi me peshë për rritjen e *investimeve të buaja në ekonominë* e vendit duket se nuk ka arritur të jetë më shumë se 3.6 miliard Euro në 4 vitet e qeverisjes së PS dhe LSI edhe pse është 800 milion Euro më shumë, por që mbetet fakt se disa investime janë firmosur në fund të mandatit të qeverisjes së kaluar, të tilla si: HEC e Devoll dhe projekti TAP. Llogaritjet tona tregojnë se ka rezultuar një ndikim në të ardhurat e buxhetit deri në 7.5 miliard lekë nëpërmjet arkëtimit të taksave të konsumit, si dhe tatimit mbi të ardhurat, përfshirë edhe taksat kombëtare dhe ato vendore.

Politika fiskale e premtuar ka dhënë një efekt shtesë në të ardhurat e buxhetit me 63 miliard lekë. Ky kontribut, dukshëm më i madh gati 2.5 herë se qeverisja e kaluar vjen më së shumti nga efektet e taksave të konsumit, ku TVSH ka arkëtuar më shumë 15.8 miliard lekë dhe akciza ka arkëtuar 4.3 miliard lekë. Ndikim në këtë rritje të të ardhurave fiskale kanë edhe tatimet mbi të ardhurat, ku tatimi mbi fitimin ka një hyrje shtesë me 10.1 miliard lekë dhe tatimi mbi të ardhurat ka një hyrje shtesë me 3.3 miliard lekë. Nëse analizojmë tatimin mbi të ardhurat në këndvështrimin e efekteve nga aplikimi i taksës progresive, shihet se efektin më të madh e ka dhënë rritja e normës së tatimit të fitimit (nga 10% u rrit në 15%), ndërkohë që tatimi progresiv i cili u zbatua mbi pagat e sektorit privat dhe publik dha një shtesë në të hyrat buxhetore me vetëm 14 përqind më shumë se io në jëti tatim në qeverinë e kaluar. Ndërkohë, taksat nacionale dhe taksat e tjera bashkë me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore kanë dhënë një të ardhur shtesë me 28.5 miliard lekë. Nisur nga fakti që tatimet mbi konsumin kanë një rritje të dukshme më të mirë se në qeverisjen e kaluar (+13.9 miliard lekë) edhe pse janë bërë përjashtime për TVSH dhe një ritëm rimbursimesh më i lartë, kjo trigon për një rritje të konsumit për arsye të investimeve më të mëdha, por edhe nga formalizimi i punonjësve informalë, të cilët tashmë legalizuan konsumin e tyre në ekonominë formale. Edhe për këtë qeverisje lufta ndaj informalitetit mbeti sfidë që nuk u adresua dot sipas premtimeve të dhëna bashkë me antikorrupsion, i cili ka shënuar rritje më të madhe se qeveria paraardhëse.

Programi qeverisës dhe niveli i realizimit të premtimeve, 2017-2021

Niveli i përmbushjes nga qeveria “Rama 2” i premtimeve të dhëna në fushatë zgjedhore (për vitin 2021 vlerësimet janë ende të paverifikueshme) rezulton një nivel prej 52 përqind me një rritje të nivelit krahasuar me qeverisjen

paraardhëse me 16 përqind. Niveli i premtimeve të papërbushura është i lartë krahasuar me qeverisjen e kaluar me 14 përqind të peshës që mbajnë nga gjithë premtimet e manifestit politik.

Përbushja e *premtimit për punësimin* nuk ka arritur të kalojë nivelin e 40% të premtimit të PS me një rënie të mbajtjes së premtimit në krahasim me qeverisjen e kaluar me 26 përqind. Një ndikim në këto të dhëna vjen nga efekti i pandemisë Covid-19, e cila për vitin 2020 ka stopuar punësimet sipas ritmeve të parashikuara. Por, edhe sikur të marrim në analizë vetëm dy vitet normale të qeverisjes “Rama2”, vërehet se ritmi i rritjes së punësimeve nuk mund të kalojë më shumë se niveli i përbushjes së premtimit të 100 mijë punonjës në 4 vite. Kjo llogaritur vjen si rrjedhojë e *treguesit të zhvillimit ekonomik*, që nuk u rrit sipas premtimeve të dhëna, por edhe te niveli i njëjtë i investimeve të huaja nëse krahasohen me qeverisjen e kaluar. Nga të dhënat e cituara në tabelat analitike të kësaj analize, rezultojnë se investimet e huaja për 4 vitet e qeverisjes nuk do të kalojnë përtej 3.9 miliard Euro. Këto investime llogaritet të kenë dhënë një efekt pozitiv në ekonomi me të paktën 7.5 miliard lekë, duke patur parasysh sektorët ku është investuar dhe efektin zinxhir në të ardhurat tatimore.

Premtimet për *mbrojtjen dhe përkujdesjen sociale* nuk kanë zënë vend më të madh se në qeverinë e kaluar në programet e qeverisë, por janë ndër premtimet që premtohet se do të alokohen 8 miliard lekë fonde shtesë. Në fakt nga matja e alokimeve të realizuara ato i kanë kushtuar buxhetit 4 vjeçar 29% përqind të kostos buxhetore së premtuar. Në këtë kategori premtimesh përfshihen edhe premtimet për pensionet, të cilat nuk arritën të përbusheshin edhe pse ky premtim nuk është përbushur asnjëherë nga qeveritë që ne kemi analizuar për përbushjen e premtimeve të tyre. Në një krahasim të dy premtimeve të vitit 2017 për pensionet: (a) Paketa e solidaritetit për pensionistët 24 miliard lekë dhe (b) Rritje vjetore pensionesh dhe shpërblim fundviti nga 7-10 mijë lek, nga verifikimi i të dhënave të buxheteve 2017-2021 (ky i fundit është në zbatim) nuk rezultojnë përbushja në nivelet e premtuara.

Premtimet për *bujqësinë*, si një sektori që vijon të adresohen shumë premtime dhe në fushatën zgjedhore, vërehet se edhe pse është premtuar të shpenzohen më shumë se 35 miliardë lekë shtesë, fakti i burimeve shtesë nga buxheti arrin deri në 19% të shumës së premtuar.

Premtimet për arsimin zënë një vend nga më kryesorët në premtimet e përfshira në programin qeverisës dhe vijon si pjesë e konsistencës së premtimeve të vitit 2013. Kur krahasojmë vlerën e premtuar të buxhetit të llogaritur në 18.5 miliard lekë, rezultojnë se alokimet shtesë faktike që janë bërë në 4 vite e tejkalojnë këtë kosto të vlerës së premtimeve me 32 përqind. Alokimet shtesë kanë kaluar në pjesë të madhe për rritjen e numrit të shkollave të arsimit parauniversitar duke qenë një nga sektorët që premtimet janë përbushur në masë më të madhe se sektorët e tjerë

Për infrastrukturën rrugore, për mjedisin dhe turizmin nuk janë ka premtime të reja duke qenë se pas fushatës së vitit 2017 qeveria “Rama 2” shpalli paketën “1 miliard”. Ndërkohë, programi qeverisës vijon të mbulojë pjesën e shpenzimeve që janë paguar nga buxheti në vite rutinore duke e kaluar pjesëm më të madhe të kostos së infrastrukturës rrugore te sektori privat që ka nënshkruar marrëveshje partnershipi me qeverinë. Natyrisht, që kjo kosto do të mbulojë hapësira fiskale në 10-15 vitet në vijim duke mos lënë shumë për të planifikuar nga qeverisjet që do të vijnë. Megjithatë edhe pse nuk ka premtime me emertime në fakt velra e premtimeve të përgjithshme, sipas analizës që ne i bëmë rezultojnë në 65 miliard lekë. Në fakt aktualisht buxheti ka alokuar burime shtesë në vlerën 78 miliard lekë, por këtu përfshihen edhe kostot e inceneratorëve. Nisur nga paqartësitë dhe të dhëna të paplota ne nuk mundemi të bëjmë dot një krahasim të detajuar për nënkomponentët që përbëjnë infrastrukturën, por shprehemi edhe pse me rezerva, se vlerat e premtuar janë përbushur me alokimet shtesë buxhetore.

Kur analizojmë premtimet për ujësjellës dhe rrjetin e kanalizimeve llogaritet zënë një vlerë jo të vogël në premtimet zgjedhore të partive të koalicionit (15 miliard lekë). Në fakt, nga krahasimi me fondet e alokimeve të buxhetit për këtë sektor shikohet se është përbushur vlera e premtuar në nivelin e 80 përqind.

Politika fiskale e premtuar në analizën që ne bëmë është kufizuar në të paktën dy vite fiskalë, 2018 dhe 2019 duke marrë në konsideratë situatën e jashtëzakonshme të ndikuar prej bllokimit të ekoonomisë nga pandemia. Për periudhën e analizuar rezulton se politikat e zbatuara sipas premtimeve të vitit 2017 kanë dhënë një efekt shtesë në të ardhurat e buxhetit me 6.9 miliard lekë. Ky kontribut, është ndikuar nga rritja e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale me 9.6 miliard lekë. Në këtë rritje të lartë ka ndikuar efekti i uljes së tatimit mbi dividendin, i cili ka favorizuar pagesat nga kompanitë e mëdha që janë rezidente në Shqipëri në kontribut vjetor prej 7.8 miliard lekë.² Kjo rritje e të hyrave nga ky tatim ka mbuluar deficitet edhe për TVSH dhe tatim fitimin. Gjithashtu edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore kanë dhënë një vlerë të shtuar në buxhet me 5.3 miliard lekë.

Nëse analizojmë tatimin mbi të ardhurat personale pas më shumë se 6 vitesh nga fillimi i zbatimit të mekanizmit fiskal të taksimit progresiv shikojmë se kontributi në buxhet është 16.5 miliard lekë, ku 8 miliard lekë është kontributi vetëm nga tatimi mbi pagat. Nisur nga ky fakt buxhetor, progresiviteti është bazuar dhe rënduar mbi pagat e punonjësve, ku më i rënduari është pjesa e pagave të larta nga sektori privat. Natyrshëm, që ky kontribut është i rëndësishëm për të hyrat e buxhetit, por momenti që një taksë rëndon mbi një kategori apo segment taksapaguesish dhe nuk takson gjithë kategoritë e tjera duhet të rishikohet për një shpërndarje të re dhe të drejtë të barrës fiskale.

Kur ballafaqojmë përlllogaritjet e efekteve buxhetore dhe fiskale të premtimeve zgjedhore me vlerat e zbatuara nga buxhetet e secilës qeverisje, sipas Grafikut 9 vërehet një ndryshim midis tyre.

Realizimi faktik i buxheteve, sipas tri qeverive që kanë marrë mandatin qeverisës, rezulton se:


- qeverisja midis PD dhe LSI edhe pse ka përfshirë 61% të premtimeve të fushatës 2009 për të dyja partitë e koalicionit ka një efekt real buxhetor për të hyrat, që arrin sa 79% e premtimeve. Për shpenzimet shtesë, ka një zbatim nga buxheti sa 56% e kostove të premtuara.
- qeverisja midis PS dhe LSI edhe pse ka përfshirë 63% të premtimeve të fushatës 2013 për të dyja partitë e koalicionit ka një efekt real buxhetor për të hyrat, që tejkalon me 15% llogaritjet sipas premtimeve. Për shpenzimet shtesë, ka një zbatim nga buxheti sa 32% e kostove të premtuara.
- qeverisja e PS edhe pse ka përfshirë një numër rekord në nivelin e 93% të premtimeve të fushatës 2017 ka një efekt real buxhetor për të hyrat, që arrin sa 28% e llogaritjeve sipas premtimeve. Për shpenzimet shtesë, ka një zbatim nga buxheti sa 24% e kostove të premtuara.

Nëse analizojmë tendencën e premtimeve për të hyrat dhe shpenzimet, si efekt shtesë i bazuar te premtimet zgjedhore, shikohet se më pranë zbatimit të buxheteve faktike në reflektim të llogaritjeve elektorale është qeverisja e vitit 2009-2013, veçanërisht për shpenzimet e alokuara. Ndërkohë, për të hyrat e llogaritura si efekte nga premtimet elektorale në krahasim me administrimin real të tyre është qeverisja 2013-2017, ajo e cila trigon madje për një performancë më të mirë se vetë llogaritjet.

² <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=7511>

Grafik 9

Kostot e premtimeve dhe buxheti zbatuar sipas premtimeve, 2009-2021




Por duhet të theksojmë se në analizën e qeverisë 2017-2021 ka nevojë të shihet me kufizime si përsa i përket periudhës së vitit 2021, i cili është në fillimet e zbatimit, por edhe për arsye objektive të ndikimit të buxhetit direkt nga efekti i katastrofës natyrore dhe pandemisë, edhe pse nga analizat paraprake të buxhetit, rezultojnë ndikimi negativ në buxhetin 2020 për të hyrat është minus 6.5% (krahasuar me 2019) dhe për shpenzimet është minus 9.1% (krahasuar me 2019).


Tendencat e ofertave elektorale 2009 -2017

Grafik 4


Tendenca e premtimeve elektorale, PD



Grafik 5



Grafik 6




Nëse shikojmë **efektin real në buxhet nga ndikimi i premtimeve zgjedhore**, te Grafik 8 shihet se:

- qeverisja në vitet 2009 – 2013 ka një nivel shpenzimesh shtesë shumë të lartë se qeverisjet në vijim, ku shkaku kryesor janë shpenzimet në infrastrukturën rrugore, por edhe vijimësia me investimet e tjera kapitale dhe ato operationale. Nisur nga niveli i lartë i shpenzimeve ka edhe një rezultat të thellë negativ, i cili ka ndikuar në rritjen e borxhit publik nëse karhasohet me fillimin e mandatit qeverisës.
- qeverisja në vitet 2013-2017 ka një reflektim në shtesën e nivelit të shpenzimeve si rrjedhojë e premtimeve afër 90% më të ulët se qeverisja paraardhëse dhe me një ndikim më të ulët në rezultatin financiar, ashu si shihet edhe në grafik.

- qeverisja në vitet 2017 – 2021³ ka ruajtur nivel të afërt shpenzimesh shtesë si efekt i premtimeve të fushatës 2017, por me një rezultat më negative, krahasuar me qeverisjen paraardhëse, për arsye të një performance 2.3 herë më të ulët të të hyrave, e cila ka ndikuar direkt në këtë rezultat negativ.

Grafik 8

Efekti i buxhetit nga shtimi i shpenzimeve dhe të hyrat fiskale, 2009-2021 (vlerësim)



* llogaritjet janë vlerësime për 2021

Rast diskutim

Transformimi i partive politike në parti elektorale dhe fushata e pandërprerë

Duke pasur parasysh natyrën e premtimeve në historikun e tyre përgjatë 2009-2017, shikohet se disa premtime në zgjedhjet e 2009 dhe 2013 janë të natyrës klienteliste (p.sh. premtimet e LSI për fasonët, premtimet e PS për portet turistike dhe zonat e lira ekonomike, premtimet e PD për ish-pronarët). Në këtë analizë shikohet se në zgjedhjet e fundit partitë politike nuk bëjnë kryesisht premtime klienteliste, por me marrjen e pushtetit ato zbatojnë politika klienteliste (p.sh. programi për heqjen e rentës minerare për përpunimin e mineraleve, programi për dhënie me koncesion të tokave dhe mabjenetev për 1 euro). Tashmë partitë janë bërë parti të mirëfillta elektorale dhe nuk rrezikojnë të identifikohen gjatë fushatave zgjedhore me grupe dhe interesa të ngushta klienteliste.

³ Viti 2021 bazohet mbi të dhënat e parashikuara sipas PBA 2021-2023

www.altax.al

ALTAX

POLIFAKT_{al}

www.polifakt.al